

## Sistemi i raportimit të shkeljeve – Sinjalizimi

Intesa Sanpaolo Albania ka një sistem të brendshëm për raportimin e veprimeve ose fakteve që mund të përbëjnë shkelje të rregulloreve që rregullojnë aktivitetet bankare ose sjellje të tjera të paligjshme (Sinjalizimi).

### Kush mund të raportojë

Në përputhje me dispozitat e sinjalizimit, sistemi është efektiv që nga muaji Tetor 2018. Subjektet e mëposhtme mund të paraqesin një raport sinjalizues:

- punonjësit dhe personat e vetëpunësuar që punojnë ose kanë punuar për Bankën;
- titullarët e një marrëdhënieje bashkëpunimi profesional;
- punonjësit ose bashkëpunëtorët që ofrojnë mallra ose shërbime ose që punojnë për palë të treta dhe punojnë ose kanë punuar për Bankën;
- profesionistë të lirë dhe konsulentë që punojnë ose kanë punuar për Bankën;
- vullnetarët dhe persona të trajnuar (me ose pa pagesë);
- personat me funksione administrative, kontrolluese, mbikëqyrëse ose përfaqësuese (këtu dhe më poshtë referuar “përfaqësues”).

Procesi i Sinjalizimit, i cili integron sistemet e tjera të raportimit dhe proceset që kryhen në Bankë, mundëson raportimin, **me garancinë maksimale për ruajtjen e konfidencialitetit**, për shkeljet që dëmtojnë interesin publik ose integritetin e Bankës Intesa Sanpaolo Albania, për të cilat vihet në dijeni në kuadrin e punës, ose për shkak të marrëdhënies juridiko-ekonomike që ekziston me Bankën, **duke mbrojtur sinjalizuesin nga çdo sjellje e mundshme hakmarrëse ose diskriminuuese**.

### Si të raportoni

Raportet e sinjalizimit mund të dërgohen duke përdorur kanalin e posaçëm të komunikimit që përcaktohet më poshtë (në gjuhën shqipe dhe angleze).

Raporti duhet të mundësojë identifikimin e sinjalizuesit (emrin dhe mbiemrin, marrëdhënien me Bankën dhe të dhënat e kontaktit) dhe duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar të fakteve dhe sjelljeve që konsiderohen në kundërshtim me ligjin, duke përcaktuar gjithashtu, nëse është e mundur, dokumentet , rregulloret që vlerësohen se janë shkelur si dhe gjetjet e tjera të dobishme për hetimin e

fakteve të kontestuara. Së fundi, sinjalizuesi ka detyrimin të deklarojë nëse ai/ajo ka një interes personal në lidhje me raportin.

Drejtuesi i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm garanton zhvillimin e procesit me korrektësi.

## **Kanali i Brendshëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania**

Të gjithë sinjalizuesit i drejtohen kanalit kryesor me përjashtim të përfaqësuesve (për të cilët është parashikuar një proces i posaçëm konfidencial). Raporti do të dërgohet në adresën e mëposhtme të emailit:

[sinjalizim@intesasanpaolobank.al](mailto:sinjalizim@intesasanpaolobank.al)

Nëpërmjet kanalit të mësipërm të komunikimit, sinjalizuesi mund të kërkojë gjithashtu një takim për qëllime raportimi. Takimi do të caktohet brenda një kohe të arsyeshme nga Drejtuesi i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm.